

VENDIM
Nr. 537, datë 8.7.2020

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE MINIMALE TË PERFORMANCËS SË
ENERGJISË SË NDËRTESAVE DHE TË ELEMENTEVE TË NDËRTESAVE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kërkesat minimale për performancën e energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave, duke synuar që të arrihen nivelet optimale të konsumit energjetik për një përdorim tipik të ndërtesës.

2. Ky vendim përcakton kërkesat minimale të performancës së energjisë, për:

a) të gjitha ndërtesat e reja dhe njësitë e ndërtesave të reja gjatë të gjitha fazave të ndërtimit, përfshirë projektimin;

b) ndërtesat ekzistuese dhe njësitë e ndërtesave ekzistuese, kur ato i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm ose kur shtohen/zgjerohen, përfshirë projektimin;

c) elementet e veçanta të ndërtesës, të cilat janë pjesë e mbështjellëses së ndërtesës dhe që kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi performancën e energjisë së ndërtesës, kur ato zëvendësohen ose i shtohen ndërtesës;

ç) infiltrimet e ajrit në ndërtesë;

d) sistemet teknike të ndërtesave të reja dhe ndërtesave ekzistuese (në rastin kur instalohet një sistem i ri ose kur do të zëvendësohet) lidhur me performancën e tyre energjetike, përfshirë instalimin në mënyrën e duhur, vendosjen e sistemeve të tyre të kontrollit dhe automatizimit me qëllim rritjen e eficiencës.

3. Kërkesat e këtij vendimi zbatohen për ndërtesat rezidenciale ose të banimit sipas tipologjisë së përdorimit të stokut të këtyre ndërtesave në përputhje me pikën 7, të nenit 5, të ligjit nr. 116/2016:

a) ndërtesa të veçuara të banimit me një familje, përfshirë vilat, ndërtesa të lidhura dhe/ose shtëpi të veçuara me tarracë, të shënuara me kodin R1;

b) blloqet e apartamenteve, përfshirë ndërtesa banimi me tre ose më shumë apartamente dhe blloqet e ndërtuara nga institucionet e mirëqenies sociale, të shënuara me kodin R2.

4. Kërkesat e këtij vendimi zbatohen për ndërtesat publike dhe jorezidenciale, sipas tipologjisë dhe funksionalitetit të stokut të këtyre ndërtesave në përputhje me pikën 7, neni 5, të ligjit nr. 116/2016:

a) zyrat, përfshirë bibliotekat, ndërtesat kërkimore dhe muzeumet, e shënuara me kodin JR1Z;

b) ndërtesat e edukimit/arsimimit, përfshirë shkollat, universitetet, kopshtet, institucionet e edukimit, konviktet, gjykatat, burgjet dhe qendrat akomoduese, të shënuara me kodin JR2A;

c) spitalet, përfshirë ndërtesat e kujdesit shëndetësor, ndërtesat e rehabilitimit dhe të institucioneve të kujdesit shëndetësor, të shënuara me kodin JR3SP;

ç) hotelet dhe restorantet, përfshirë ndërtesa biznesi dhe ndërtesa akomodimi dhe shërbimi, përveç ndërtesave të zyrave dhe ndërtesave tregtare, të shënuara me kodin JR4HR;

d) ndërtesa ku zhvillohen aktivitete të tregtisë me shumicë ose pakicë që klasifikohen si ndërtesa shërbimi, përfshirë ndërtesa argëtuese, tregtare dhe ndërtesa stacioni/terminale, të shënuara me kodin JR5SH;

¹ Ky vendim përafrohet pjesërisht direktivën 2010/31/EU, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 maj 2010, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, e ndryshuar. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 153/13, datë 18.6.2010. L 81/18, CELEX- 32010L0031.

e) objektet sportive, përfshirë objektet e mbyllura, përveç shesheve me akull të brendshëm, të shënuara me kodin JR6S.

5. Termat e përcaktuar në ligjin nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) **“Vlera U, ose vlera specifike e koeficientit të përgjithshëm të transmetimit të nxehtësisë [W/(m²K)]”**, humbja totale e nxehtësisë specifike përmes një elementi humogjen (mur, dritare, çati, tarracë, derë e jashtme dhe dysheme e mbështetur me tokën, përfshirë rezistencat termike për konveksion dhe rrezatim brenda dhe jashtë mbështjelljes) të mbështjelljes së ndërtesës për metër katror të sipërfaqes së elementit, për një ndryshim prej një gradë Kelvin midis temperaturës së brendshme dhe asaj të jashtme.

b) **“Konsumi total i energjisë së ndërtesës (kWh/vit)”**, sasia në kWh e energjisë ekuivalente të dhënë, e cila konsumohet përgjatë një viti përmes përdorimit të sistemeve teknike të ndërtesës për kontrollin e klimës së brendshme për ngrohjen, për ftohjen, për ngrohjen e ujit sanitar, për ventilimin, për ndriçimin dhe për funksionimin e pajisjeve të tjera elektrike.

Nga bilanci për konsumin total të energjisë në ndërtesë janë zbritur energjitë e rinovueshme të pakontrolluara që hyjnë në ndërtesë në formë pasive (diellore dhe ajri), si edhe energjia e rinovueshme e prodhuar për vetëkonsum brenda ndërtesës, së bashku me energjinë aerotermike ose gjeotermike të rinovueshme, të përdorur nga pompat e nxehtësisë.

Në bilancin vjetor për konsumin total të energjisë në ndërtesë do të përfshihen të gjitha humbjet e energjisë nga sistemet teknike, përfshirë burimet e energjisë, sistemet e gjenerimit të nxehtësisë, të shpërndarjes dhe të transformimit të energjisë.

c) **“Nevoja për energji”**, sasia e energjisë (elektrike dhe/ose termike pa marrë parasysh humbjet e sistemit dhe shndërrimet e energjisë) e nevojshme për kontrollin e klimës së brendshme në ngrohje/ftohje, ngrohjen e ujit për nevoja sanitare, ndriçimin, ventilimin dhe funksionimin e pajisjeve ndihmëse për realizimin e këtyre nevojave përmes energjisë termike dhe/ose elektrike. Nevoja për energji përfshin: nevojën për energji primare për ngrohjen/ftohjen e hapësirës, ngrohjen/ftohjen e ajrit të ventilimit, ngrohjen e ujit shtëpiak, ndriçimin dhe energjinë për funksionimin e pajisjeve.

ç) **“Përdorimi tipik i një ndërtese”**, përdorimi normal nga pikëpamja e funksioneve dhe numri i personave (okupantëve) në një ndërtesë, e cila sillet në përputhje me kërkesat minimale të performancës së energjisë, që merr parasysh qëllimin e përdorimit të ndërtesës, gjendjen e kushteve klimatike të mjedisit të jashtëm dhe klimatizimin e mjedisëve të brendshme, kohën gjatë së cilës ndërtesa dhe sistemet e saj teknike përdoren dhe fitimet/humbjet e nxehtësisë ndodhin gjatë këtij përdorimi tipik ose standard.

d) **“Ndërtesat publike”**, në Shqipëri janë çdolloj ndërtesë që është e aksesueshme për punonjësit dhe publikun, të cilat janë pronë dhe financohen përmes parave të taksave nga qeverisja qendrore dhe bashkitë. Të gjitha llojet e zyrave të shërbimeve qeveritare dhe ato të bashkive konsiderohen ndërtesa publike.

II. KËRKESAT MINIMALE TË PERFORMANCËS SË ENERGISË NË NDËRTESA

II.1 Kërkesat minimale të performancës së energjisë për mbështjelljen e ndërtesës dhe elementeve të veçanta të saj

Ndërtesat e reja dhe njësitë e tyre, si edhe ndërtesat ekzistuese dhe njësitë e tyre kur këto të fundit i nënshtrohen një rinovimi (ose rikonstruksion) të rëndësishëm përmbushin kërkesat e mëposhtme lidhur me performancën e energjisë:

1. Humbjet e nxehtësisë me transmetim nga mbështjellja (ku përfshihen muret, dritaret, dyert, çatia dhe dyshemeja e mbështetur me tokën) e ndërtesave të reja dhe njësitë e ndërtesave të reja të shprehura me koeficientin e përgjithshëm të transmetimit të nxehtësisë U nuk tejkalojnë vlerat e lejuara të këtij koeficienti, të përcaktuara më poshtë:

a) muret e jashtme në kontakt me mjedisin e jashtëm:	$U = 0.38 \text{ (W/m}^2\text{K)}$
b) çatia (e pjerrët ose tarracë):	$U = 0.35 \text{ (W/m}^2\text{K)}$
c) soleta e papafingos:	$U = 0.38 \text{ (W/m}^2\text{K)}$
ç) dysheme e mbështetur në tokë:	$U = 0.5 \text{ (W/m}^2\text{K)}$
d) komponentët me xham (dritaret me kornizë alumin i izoluar, plastike, druri etj.), në të cilët vlera U për strukturat transparente	$U = 2.00 \text{ (W/m}^2\text{K)}$

(dritaret) përfshin xhamin dhe kornizën:

2. Humbjet e nxehtësisë me transmetim nga mbështjellësja (ku përfshihen muret, dritaret, dyert, çatia dhe dysHEMEJA e mbështetur me tokën) e ndërtesave ekzistuese dhe njësitë e ndërtesave ekzistuese, kur ato i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm dhe/ose kur shtohen/zgjerohen, të shprehura me koeficientin e përgjithshëm të transmetimit të nxehtësisë U , nuk tejkalojnë vlerat e lejuara të këtij koeficienti, të përcaktuara më poshtë:

- | | |
|---|------------------------------------|
| a) muret e jashtme në kontakt me mjedisin e jashtëm: | $U = 0.40 \text{ (W/m}^2\text{K)}$ |
| b) çatia (e pjerrët ose tarracë): | $U = 0.35 \text{ (W/m}^2\text{K)}$ |
| c) soleta e papafingos: | $U = 0.45 \text{ (W/m}^2\text{K)}$ |
| ç) dysHEMEJA e mbështetur në tokë: | $U = 0.5 \text{ (W/m}^2\text{K)}$ |
| d) komponentët me xham (dritaret me kornizë alumin i izoluar, plastike, druri etj.), në të cilët vlera U për strukturat transparente (dritaret) përfshin xhamin dhe kornizën: | $U = 2.20 \text{ (W/m}^2\text{K)}$ |

3. Çdo element i veçantë i ndërtesës ekzistuese si, dysHEMEJA, muret e jashtme, dritaret dhe/ose çatia, për të cilat në gjendjen para rinovimit vërtetohet që kanë vlerën U , nën vlerat e U -së (shprehur në $\text{W/m}^2\text{K}$) të përcaktuara në kreun II.1, pikat 1 dhe 2, nuk është e detyrueshme të zvogëlohet më tej për shkak të rinovimit.

4. Kur rinovimi i një ndërtese ekzistuese përfshin rikonstrukcionin për zgjerimin e sipërfaqes së dysHEMESË së ndërtesës në masën mbi 30%, atëherë kjo shtesë konsiderohet si ndërtesë e re dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të ndarjes II.1, të këtij kreu.

5. Kur njëri nga elementet e veçuara nga mbështjellësja e ndërtesës, si për shembull një dritare, derë e jashtme ose një mur i tërë, zëvendësohet tërësisht, elementi zëvendësues plotëson standardin e kërkuar në pikën 2, të ndarjes II.1, të këtij kreu.

6. Kërkesat minimale të performancës së energjisë për ndërtesat dhe njësitë e ndërtesave, që do t'i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm, nuk zbatohen nëse zbatimi i këtyre kërkesave nuk përputhet me nivelin optimal të kostos, pra nuk është teknikisht ose praktikisht i realizueshëm dhe ekonomikisht i justifikueshëm për të gjithë jetëgjatësinë e ndërtesës.

7. Nivelet e performancës energjetike, që synohen të arrihen, përcaktohen në përputhje me metodologjinë e miratuar për llogaritjen e niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave.

II.2 Kërkesat minimale të performancës së energjisë në sistemet teknike të ndërtesës

1. Të gjitha sistemet teknike për ndërtesat e reja rezidenciale dhe jorezidenciale, si edhe njësitë e tyre në fazën e projektimit miratohen dhe specifikohen nga audituesi i certifikuar i energjisë të kenë performancë të lartë të energjisë, në përputhje me standardet indikative minimale të eficiencës së energjisë, të përcaktuara në tabelën 1, të shtojcës I, si dhe kërkesat e standardeve kombëtare të produktit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 68/2012.

2. Për qëllime të llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesë dhe për të plotësuar kërkesat për energji me qëllim plotësimin e kërkesave minimale të komfortit njerëzor në to, ndër të tjera, llogaritja e energjisë së përdorur për ngrohjen, ftohjen, ventilimin, prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe ndriçimit, bëhet për nivelet optimale të kostove në përputhje kërkesat minimale për:

- temperaturat minimale të zonave të ndërtesës për ngrohjen e hapësirës në ($^{\circ}\text{C}$);
- temperaturat maksimale të zonave të ndërtesës për ftohjen e hapësirës në ($^{\circ}\text{C}$);
- vlerat minimale të ajrit të freskët që ventilon hapësirën në ($\text{lit/m}^2\text{/person}$);
- sasinë minimale të ujit të ngrohtë sanitar në (lit/person/ditë);
- nivelin minimal të ndriçimit në (lux/m^2).

Kërkesat minimale më sipër janë vendosur në tabelën 2, të shtojcës I, dhe marrin në konsideratë numrin minimal të personave që okupojnë 1 m^2 të ndërtesës (persona/m^2), së bashku me nivelin e metabolizmit (W/person) ose të nxehtësisë që çliron personi që okupon hapësirën. Këto vlera konsiderohen të pandryshuara gjatë përdorimit tipik të ndërtesës dhe zonave të saj.

3. Për ndërtesat ekzistuese dhe njësitë e tyre (rezidenciale dhe jorezidenciale) që i nënshtrohen ose jo një rinovimi apo rikonstrukcionin të rëndësishëm, kur një pjesë e sistemeve teknike

instalohet ose zëvendësohet, sistemi teknik i zëvendësuar apo instaluar i ri duhet të ketë një eficiencë energjetike në përputhje me standardet indikative minimale të eficiencës së energjisë, të përcaktuara në tabelën 1, të shtojcës I, të këtij vendimi.

4. Për ndërtesat e reja dhe njësitë e tyre dhe për ndërtesat ekzistuese dhe njësitë e tyre që i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm, kur parashikohet instalimi i ri i sistemit të ventilimit rekomandohet të përfshihet gjithmonë edhe rekuperatori i nxehtësisë me standardet indikative orientuese të eficiencës së energjisë, të përcaktuara në tabelën 1, të shtojcës I, të këtij vendimi.

5. Në të gjitha rastet kur kërkohet leje ndërtimi për një ndërtesë të re dhe njësitë e saj si dhe për rinovimin apo rikonstruksionin e rëndësishëm të një ndërtese ekzistuese dhe njësitë e saj, në raportin e auditimit dhe të verifikimit të energjisë, që shoqëron certifikatën e performancës së energjisë, jepen prova se janë analizuar mundësitë e përdorimit të sistemeve alternative me eficiencë të lartë, të parashikuara, si më poshtë:

a) sistemet e decentralizuara të furnizimit me energji që shfrytëzojnë burime të rinovueshme të energjisë, siç janë sistemet fotovoltaike vetëprodhuese për ndërtesën që rinovohet apo ndërtohet e re, panelet diellore për ujën e ngrohtë, pompat e nxehtësisë me performancë të lartë të ftohura me energji gjeotermike apo në ujërat sipërfaqësore për ngrohje/ftohje dhe ujë të ngrohtë sanitar;

b) sistemet koogjeneruese;

c) sistemet me pompa nxehtësie me koeficient performancë të lartë;

ç) sistemet e ngrohjes dhe ftohjes individuale dhe/ose të përqendruara, veçanërisht ato që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie që përdoren në qytete;

d) sistemet e ngrohjes së ujit me burime të rinovueshme;

dh) rikuperimi i energjisë në sistemet e ventilimit;

e) ndriçimi eficient duke përjashtuar llambat inkandeshente.

6. Përputhshmëria e ndërtesës me kërkesat minimale për performancën e energjisë në sistemet teknike të ndërtesës vlerësohet në bazë të lëshimit të certifikatës paraprake të performancës së energjisë pas regjistrimit të saj nga AEE-ja, gjatë fazës së projektimit, dhe me përfundimin e ndërtesës, dëshmia e përputhshmërisë me këto kërkesa sigurohet me lëshimin e certifikatës përfundimtare të performancës së energjisë.

II.3 Performanca e plotë e integruar e energjisë së ndërtesës

1. Konsumi total vjetor i energjisë së ndërtesës për një metër katror të sipërfaqes së përdorshme (të okupuar) të saj përfshin shumën e nevojës për energji primare për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë sanitar dhe ndriçim sipas përdorimit tipik të ndërtesës dhe vlerësohet nëpërmjet gjenerimit të certifikatës së performancës së energjisë (ÇPE), duke përdorur Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së integruar të energjisë së ndërtesave të reja apo të rinovuara dhe të njësitë të këtyre ndërtesave, të miratuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, dhe programin kompjuterik të miratuar.

2. Ndërtesa konsiderohet se është në përputhje me kërkesat minimale të performancës së energjisë, nëse vlera e llogaritur e shkallës së eficiencës së energjisë primare në ÇPE është më e vogël ose e barabartë me 50.

Shkalla e eficiencës së energjisë primare përcaktohet si shumëzim i numrit pa përmasë 50 me raportin e nevojës për energji (në kWh/m² në vit) nga ndërtesa aktuale (NEA) e marrë në shqyrtim, mbi normën e synuar të nevojës për energji (në kWh/m² në vit) të ndërtesës referente (NER).

3. Certifikata e përkohshme për performancën e energjisë për ndërtesën e projektuar paraqitet si pjesë e aplikimit për leje ndërtimi. Regjistrimi i saj në AEE bëhet nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat e seksionit II.1 dhe II.2 dhe në pikën 2, të këtij seksioni.

4. Certifikata përfundimtare për performancën e energjisë për ndërtesën lëshohet pas përfundimit të ndërtesës në përputhje me përdorimin tipik (standard) të ndërtesës dhe vlerën e përcaktuar në pikën 2, të këtij seksioni.

5. Ministria e përgjegjëse për energjinë, në jo më pak se çdo pesë vjet, e rishikon këtë vlerë kufi dhe e ndryshon këtë vendim për të vendosur një kufi të ri, më të ulët, nëse analiza e kostos optimale tregon që kjo është e justifikuar.

II.4 Kërkesat minimale për ndërtesat me performancë “afër zero energji”

1. Ndërtesa konsiderohet se është me performancë “afër zero energji” nëse i plotëson kërkesat e mëposhtme:

a) raporti i konsumit total të energjisë së ndërtesës aktuale për një m² të sipërfaqes, ndaj nevojës për energji të një m² të ndërtesës referente, i shprehur në përqindje, të jetë më i vogël se 50%;

b) raporti i energjisë së rinovueshme të prodhuar në ndërtesë gjatë një viti kundrejt konsumit total të energjisë të ndërtesës aktuale për një m² të sipërfaqes, i shprehur në përqindje të jetë më i madh se 50%;

c) vlera e llogaritur e shkallës së eficiencës së energjisë primare në CPE të jetë më e vogël se 25.

2. Verifikimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, bëhet nga auditues energjetikë të certifikuar nga AEE-ja, të cilët gjatë kryerjes së auditimit të energjisë së ndërtesës janë bazuar në Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes, përmes përdorimit të programit kompjuterik të miratuar për gjenerimin e CPE.

3. Të dhënat mbi përputhshmërinë me standardin e ndërtimit me konsum “afër zero energji” përfshihen nga audituesi i energjisë në certifikatën e performancës së energjisë.

III. PROJEKTIMI DHE ZBATIMI I KËRKESAVE MINIMALE PËR PËRFORMANCËN E ENERGISË NË NDËRTESTAT

III.1 Detyrimet e subjekteve projektuese ndaj projekteve për ndërtesat e reja dhe atyre që i nënshtrohen rinovimit të rëndësishëm

1. Subjektet juridike projektuese, gjatë përgatitjes së projektit të ndërtesave të reja apo njësive të ndërtesave të reja, parashikojnë të gjitha aspektet e lidhura me ndërtimin, përfshirë:

a) materialet e ndërtimit dhe përmasat për secilin element;

b) materialet izoluese dhe trashësinë e tyre;

c) nyjat termike ose urat ndërmjet elementeve;

ç) llojin dhe performancën e sistemeve teknike (ngrohje, ftohje, ndriçim, ventilim, ujë i nxehtë);

d) kontrollin manual ose automatik të këtyre sistemeve.

2. Subjektet juridike projektuese kryejnë llogaritjet për përzgjedhjen e sistemeve teknike në përputhje me përcaktimet në këtë vendim ose drejtpërdrejt ose me ndihmën e ekspertëve ose audituesve të energjisë, për të siguruar:

a) vlerat U për çdo element mbështjellës të ndërtesës (mure, dritare, dysheme, çati, dyer), të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të kreut II.1;

b) vendosjen e fuqisë së instaluar të sistemit të ngrohjes në përputhje me kërkesat minimale të komfortit, të parashikuara në kreun II.2, pika 2, shkronja “a”;

c) vendosjen e fuqisë së instaluar të sistemit të ftohjes në përputhje me kërkesat minimale të komfortit, të parashikuara në kreun II.2, pika 2, shkronja “b”;

ç) vendosjen e sistemit të ventilimit për të respektuar vlerat e ajrit të freskët që ventilon hapësirën në përputhje me kërkesat minimale të komfortit, të parashikuara në kreun II.2, pika 2, shkronja “c”. Sistemi i ventilimit mund të jetë i integruar me sistemin qendror të ngrohje/ftohjes dhe duhet të parashikojë vendosjen e sistemit të rikuperimit të nxehtësisë për të reduktuar sasinë e energjisë të nevojshme për të arritur kërkesat minimale të furnizimit me ajër të freskët;

d) vendosjen e sistemit për prodhimin (ngrohjen) e ujit të ngrohtë sanitar (UNS) në përputhje me kërkesat minimale të komfortit, të parashikuara në kreun II.2, pika 2, shkronja “ç”;

dh) vendosjen e sistemit të ndriçimit në përputhje me kërkesat minimale të komfortit, të parashikuara në kreun II.2, pika 2, shkronja “d”.

3. Në bazë të rezultateve të llogaritjes së performancës së energjisë nga programi kompjuterik i miratuar, subjekti juridik projektues konfirmon nëse ndërtesa përputhet me kërkesat minimale për performancën e energjisë së ndërtesave. Në rast se këto kërkesa nuk përputhen, projekti ndryshohet derisa të përputhet me kërkesat e këtij vendimi.

4. Subjekti juridik projektues regjistron/përshekruan të gjitha specifikimet teknike në vizatimet dhe planet e detajuara inxhinierike. Këto specifikime përmbajnë të gjitha vlerat e përzgjedhura për kërkesat minimale të performancës së energjisë në përputhje me këtë vendim.

5. Gjatë aplikimit për të marrë leje ndërtimi në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, subjekti juridik projektues pajiset me certifikatën paraprake për performancën e energjisë për ndërtesën e projektuar nga audituesi energjetik i certifikuar nga AEE-ja.

III.2 Aprovimi i projektit

1. Subjekti juridik projektues/aplikanti si pjesë të dokumentacionit tekniko-ligjor që paraqet pranë autoriteteve përkatëse, ku aplikohet për leje ndërtimi, paraqet edhe certifikatën paraprake për performancën e energjisë, të lëshuar nga Audituesi Energjetik i Certifikuar, së bashku me “Deklaratën e përgjegjesisë profesionale”, nëpërmjet të cilës ai konfirmon dhe mban përgjegjësi për përputhshmërinë e projektit të propozuar me legjislacionin në fuqi që përcakton kërkesat minimale për performancën e energjisë së ndërtesave.

III.3 Aprovimi përfundimtar

1. Për ndërtesën e përfunduar, me qëllim marrjen e certifikatës së përdorimit të miratuar nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, aplikanti paraqet raportin përfundimtar të auditimit të eficiencës së energjisë, certifikatën përfundimtare të performancës, të lëshuar nga Audituesi Energjetik i Certifikuar dhe regjistruar pranë AEE-së, së bashku me “Deklaratën e përgjegjesisë profesionale”, nëpërmjet të cilës ai konfirmon dhe mban përgjegjësi për përputhshmërinë e projektit të përfunduar me legjislacionin në fuqi që përcakton kërkesat minimale për performancën e energjisë së ndërtesave.

III.4 Zbatimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë për ndërtesat ekzistuese

1. Pronarët e ndërtesave me ndihmën e subjekteve juridike projektuese/zbatuese aplikojnë pranë autoriteteve aprovuese për të marrë leje ndërtimi me qëllim kryerjen e punimeve rinovuese në ndërtesë.

2. Pronari i ndërtesës ose subjekti juridik projektues i kontraktuar nga ai jep detaje për punimet që do të kryhen, duke përfshirë:

a) ndërhyrje me qëllim përmirësimin e performancës së energjisë në mbështjelljen e ndërtesës ose elementeve të veçanta të saj sipas parashikimeve të këtij vendimi;

b) ndërhyrje për ndryshimin e sistemeve ngrohëse/ftohëse, të ventilimit, UNS dhe ndriçimit me qëllim përmirësimin e performancës së energjisë të sistemeve teknike në përputhje me parashikimet dhe rekomandimet e këtij vendimi.

3. Pronari i ndërtesës ose subjekti juridik projektues, në projektin e rinovimit evidenton rezultatet e vlerave të U-së dhe eficiencën e sistemeve teknike të ndërtesës duke e krahasuar me vlerat fillestare sipas një raporti të audituesit.

4. Autoriteti aprovues vendos për të lëshuar ose jo lejen e ndërtimit/rinovimit pas rishikimit të dokumenteve të depozituara duke i krahasuar rezultatet me kërkesat e këtij vendimi.

5. Nëse kërkesat janë përmbushur, autoriteti aprovues lëshon lejen për rinovim.

6. Nëse këto kërkesa nuk janë përmbushur, autoriteti refuzon duke kërkuar rishikimin e projektit.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të gjitha bashkitë dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 3 (tre) muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCË I
KËRKESAT ORIENTUESE TË PERFORMANCËS SË ENERGJISË PËR SISTEMET
TEKNIKE TË APLIKUARA NË NDËRTESA

Tabelë 1. Standardet indikative orientuese të eficiencës së energjisë të sistemeve teknike që zëvendësohen apo instalohen të reja

<i>Burimi termik</i>	<i>Sistemi teknik për ngrohje/ftohje</i>	<i>Njësia që kërkohet</i>	<i>Kërkesa minimale</i>	
Biomase drusore	Me oxhak të hapur	Rendimenti termik	0.15	
	Oxhak me qarkullim ajri në dhomë		0.35	
	Oxhak me këmbyes nxehtësie të instaluar gaz - ajër/ujë		0.70	
	Sobë druri me eficiencë		0.80	
Pellet	Ngrohëse lokale		0.85	
	Ngrohëse uji me qarkullim të ujit të ngrohtë në ndërtesë		0.90	
Gaz natyror	Kaldajë standarde me ujë të ngrohtë qarkullues		0.85	
	Kaldajë me kondensim me ujë të ngrohtë qarkullues		0.95	
Naftë	Kaldajë standarde me ujë të nxehtë qarkullues		0.86	
Energji Elektrike	Akumulator		Koeficienti i performancës (COP)	1.00
	Panel ngrohjeje, ngrohje me rreze infra të kuqe, ngrohje radiante, boiler elektrike, oxhak ngrohës elektrik			1.00
	Ngrohës me rrezatim			0.86
	Pompë nxehtësie ajër-ajër ose ajër-ujë			3.00
	Pompa nxehtësie gjeotermale			3.70
	Ventilatorë futje ajri periodike - për fuqinë specifike (SFP)			0.50
	Ventilatorë futje ajri i vazhduar		0.70	
	Ventilatorë futje ajri i vazhduar me rikuperim nxehtësie	1.50		
	Ventilim qendror i balancuar për ngrohje dhe ftohje	2.00		
	Ventilim qendror i balancuar vetëm për ngrohje	1.80		
	Ventilim – dhënës periodik	0.50		
	Njësiti e ventilatoreve	0.50		
	Nxehtësia e larguar nga kuzhina nga ventilatori dhe filtri	1.00		
	Këmbyes të nxehtësisë ajër-ajër i rrafshët	Në %	50%	
	Këmbyes të nxehtësisë në tubacionet e shpërndarjes		60%	
	Këmbyes nxehtësie rrotativ		65%	
	Këmbyes nxehtësie tub-me-tub		45%	

KËRKESAT MINIMALE TË KOMFORTIT

Tabelë 2. Normat e komfortit për nivelin e temperaturës së brendshme në ngrohje/ftohje, të ujit të ngrohtë sanitar, ndriçimit dhe ajrit të freskët për tipologji të ndryshme të zonave të ndërtesave rezidenciale (R) dhe jorezidenciale (JR) dhe densiteti i okupimit të zonës së bashku me nivelin metabolik (energjinë e çliruar nga okupantët)

Tipologjia e zonës (kodi)	Emërtimi i zonës	Densiteti i okupimit (pers/m ²)	Niveli metabolik (W/pers)	“Set Point” në ftohje (°C)	“Set Point” në ngrohje (°C)	Sasia e ajrit të freskët (lit/m ² /pers)	Ndriçimi ² (lux)	UNS (lit/pers/dit)
R&JR	Dhomë gjumi	0.10	140	26	20	10	125	0.53
R&JR	Dhomë me bimë	0.11	180	26	20	10	200	0.00

² Kërkesat teknike, termat kryesore për ndriçimin e ndërtesave dhe normat bazë të projektimit të ndriçimit janë të përcaktuara në Standardin SSH EN 12464-1:2011, “Drita dhe ndriçimi”, e miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, si standard shqiptar më 2012.12.20.

	Dhomë ngrënie	0.21	110	26	23	10	150	6.00
	Dhomë për ushqime	0.18	180	25	23	25	500	0.33
	Korridore/shkallë	0.02	180	26	22	10	100	0.53
	Kuzhinë	0.11	140	26	22	10	200	0.00
	Lavanteri	0.12	160	26	17	12	300	40.0
	Magazinë	0.11	140	26	22	10	50	0.00
	Palestër	0.04	300	26	16	10	300	0.00
	Pishina	0.14	160	32	28	15	300	0.00
	Tualet/WC, me dush	0.02	140	26	22	12	100	0.53
	Tualet/WC	0.02	120	26	22	12	150	0.53
	Dhomë zhveshje	0.10	140	26	22	10	100	30.0
R*&JR	Dhomë qëndrimi	0.02	110	26	22	10	150	0.53
R&JR	Fitness	0.16	300	26	22	30	150	0.00
JR**	Dhomë serveri	0.10	140	26	22	10	100	0.00
JR5SH	Dyqan	0.12	140	26	22	10	600	0.04
	Magazinim – të ftohta	0.12	140	26	22	10	600	0.04
	Zonë qëndrimi, check-in	0.34	100	26	22	10	300	0.15
	Zonë shitje	0.10	140	26	22	10	600	0.04
	Zyrë e përgjithshme	0.20	140	26	22	10	350	0.17
	Zyrë konsultimesh	0.10	123	26	22	10	400	0.19
	Skenë, podium, fitness	0.06	180	26	22	10	500	0.21
JR3SP	Imazheri	0.10	140	26	22	81	1000	0.60
	Salla e operacioneve	0.13	160	22	22	129	1000	1.30
	Morgu	0.05	235	20	20	161	1000	1.30
JR2A	Klasë	0.20	140	26	22	5	300	0.15
	Laborator/kompjuterë	0.21	160	26	22	12	800	0.00
	Reception	0.10	140	26	22	10	200	0.03
	Salla leksioni/mbledhje	0.22	140	26	22	10	300	0.15
	Qeli (burg në polici)	0.14	100	28	20	10	100	0.00
	Sallë e mësuesve	0.55	140	26	22	5.5	280	1.35
JR1Z	Zyra dhe konsulencë	0.11	128	26	22	10	400	0.17

**JR - Jorezidencial *R - Rezidencial